



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 01.11.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **25.10.2023**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **2A Group SH.P.K**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i QKMF ne Drenas"** me Nr. të Prok: **206-23-6378-5-1-2** nxjerr:

V E N D I M

1. **REFUZOHET**, si pjesërisht e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik **2A Group SH.P.K** e dt. 25.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Ndërtimi i QKMF ne Drenas"** me Nr. të Prok: **206-23-6378-5-1-2** kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 24.10.2023.
2. Mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e AK të datës 24.10.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **2A Group SH.P.K** me datë 25.10.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i QKMF ne Drenas"** me Nr. të Prok: **206-23-6378-5-1-2**. Autoriteti Kontraktues, me datë 01.11.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas **2A Group SH.P.K**:

Neni 1 – Qëllimi

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

OE "2A Group" SH.P.K, paraqet këtë kërkesë për rishqyrtim me pretendimet për shkelje të natyrës absolute, të përcaktuara me dispozitat e Ligjit Nr.04/I-42 Për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092(Versioni i Konsoliduar) neni 1 i LPP-Qellimi, neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, neni 41 RRUOP Ekzaminimi,Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës, neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale, paraqesim këtë kërkesë për rishqyrtim duke konsideruar që Autoriteti Kontraktues gjatë procedurës paraprake të vleresimit të tenderëve ka bërë shkelje të dispozitave të cilat derivojnë në nevojën e anulimit të vendimit.

Ne si Operator Ekonomik me datë 24.10.2023 kemi pranuar letren standarde për tenderuesin e eliminuar gjatë vlersimit të tenderit Ndertimi i QKMF në Drenas me nr.Prokurimit 206-23-6378-5-1-2, me pretendimin e Autoritetit Kontraktues se tenderi ynë për eliminuar per 2 arsye:

Arsyeja e 1-re e pretenduar nga AK-es per eliminimin tone:

Jemi eliminuar per arsye se nuk kemi ofruar deshmine e kerkuar si ne dosje te tenderit, per pune te kryera ne vlere 3 milion EURO. Nuk kemi deshmuar me Referencat ose Raportet-Procesverbalet e pranimit teknik. Ne dokumentacion jane bashkangjitur Raportet e Perkoshme te Pranimit, gje qe eshte e papranueshme.

Pergjigje ne arsyen e 1-re te pretenduar nga AK-es per eliminimin tone:

Arsyetimi i AK-es eshte i pabazuar sepse ne kemi dorezuar Listen e kontratave te perfunduara me sukses, Ne kontraten e pare e realizuar ndermjet kompanise 2T shpk-Dega ne Kosove dhe Ministrise Ekonomise ne vlere 4,247,650.20€ eshte e bashkangjitur kontrata, raportet e perkoshme te pranimit teknik me dt.19.08.2021 si dhe FINAL PROGRESS REPORT ON DPL te dates 19.08.2022 atehere edhe kur ka perfundu periudha e mirembajtjes .Kontratat e 2,3,4 jane kontrata te realizuara ndermjet kompanise 2A Group SHPK dhe Millenium Foundation Kosovo, ku gjithashtu jane te bashkngjitura kontratat, amandamentet si dhe Close Form Out (pranim perfundimtar te punimeve) se bashku kane vleren 1,360,260.74€,Kontrata e 5 eshte kontrate e realizuar ndermjet kompanise 2A Group shpk dhe Fondit Kosovar per Energji dhe Eficience ne vlere 1,560,995.72€ , bashkangjitur kontrata dhe pranimi i perkohshem i punimeve meqenese eshte ne fazen e mirembajtjes nuk ka pranim perfundimtare. Kontrata e 6 eshte kontrate e realizuar ndermjet kompanise 2A Group shpk dhe Ministrise se Punes dhe Mireqenies Sociale, bashkangjitur kontrata dhe situacioni i fundit me pranim te perkohshem te punimeve ne vlere 2,043,114.59€.Pra gjithsej punime te perfunduar dhe me pranime teknike finale jane ne vlere 5,607,910.94€ qe automatikisht plotesohet kriteri per pune te kryera ne vlere prej 3 milion EURO, dhe punet qe kane perdunduar por qe jane ne peridudhen e mirembajtjes njevjeqare ne vlere 3,604,110.31€

Per sqarimin tuaj sipas Ligjit te LPP-se dhe RRUOPP Neni 39.Sqarimi i Tenderve pika 39.8 AK duhet të dërgojë "Kërkesë për sqarim të tenderit" OE përmes sistemit të prokurimit elektronik, dhe OE duhet të dorëzojë përgjigjen e tyre tek AK në një dokument të shkruar me anë të sistemit elektronik, jane listuar shembuj se si duhet vepruar me raste po citoj "Kur mungon referenca/certifikata e pranimit nga lista e kontratave te prezantuara- Mund te kerkohen informata sqaruese", andaj ju si AK keni bere shkelje duke mos rrespektuar rregullat dhe udhezuesin operativ te prokurimit rrespektivisht neni 69 i LPP-se dhe na keni eliminuar si te papergjegjshem.

Arsyeja e 2-te e pretenduar nga AK-es per eliminimin tone:

Deklarat nen betim te 2A eshte nenshkruar nga pronari Valon Ademi, po ashtu edhe deklarata nen betim e 2T eshte paraqitur Valon Ademi si administrator, mirepo dallon nenshkrimi ne mes dy deklaratave, Ne Qetifikatat e biznesit pronar ne 2A eshte Valon Ademi dhe person i autorizuar ne 2T eshte Valon Ademi me te njejtin nr. personal.

Pergjigje ne arsyen e 2-te te pretenduar nga AK-es per eliminimin tone:

Edhe kjo arsye eshte gjithashtu e pabazuar sepse ne kemi paraqitur deklaraten nen betim per te dy operatoret ekonomik te konzorciumit duke rrespektuar Nenin 71 te LPP dhe RRUOPP, përkatësisht kompanise "2A Group

shpk" dhe kompanise "2T shpk-Dega ne Kosove". Nuk ka asnje ligj qe e ndalon pjesmarjen ne konzorcium te kompanive ku pronar rrespektivisht administrator eshte i njejti person, derisa nuk ka konflikt interesi. Ne kete rast nenshkrimi dallon ngase per kompanine 2A Group shpk ka nenshkruar personi i autorizuar (bashkangjitur e gjeni autorizimin te noterizuar), ndersa per 2T ka nenshkruar vet administratori ne kete rast Valon Ademi Eshte lehte e verifikueshme se deklarata nen betim por edhe dokumentat tjera jane te nenshkruara konform ligjit dhe nuk asnje shkelje.

Edhe ne kete rast eshte kusht administrativ qe te kerkohej informata sqaruese nga OE , kjo eshte e rregulluar me LPP-ne dhe RRUOPP Neni 39.Sqarimi i Tenderve pika 39.8 AK duhet të dërgojë "Kërkesë për sqarim të tenderit" OE përmes sistemit të prokurimit elektronik, dhe OE duhet të dorëzojë përgjigjen e tyre tek AK në një dokument të shkruar me anë të sistemit elektronik.

Kerkojme nga Autoriteti Kontraktues qe te bej anulimin e vendimit i cili vendim eshte bere ne shkelje te rende te LPP-se dhe Ligjeve ne fuqi dhe kete lende ta ktheje ne rivleresim duke respektuar dispozitat e LPP-se dhe duke marre ne konsiderate te gjitha shkeljet e evidentuara dhe te respektohen kriteri per dhenie te kontrates. I rezervojme te gjitha te drejttat tona ligjore qe te mbahemi te informuar ne te gjitha fazat e ketij procesi.

Dëmet materiale

Shkelja e dispozitave të mësipërme, tentojnë t'i shkaktojnë dëme të konsiderueshme kompanisë sonë, të cilat përpos dëmeve materiale që kanë të bëjnë me shpenzimet e ofertimit në këtë aktivitet dhe fitimit të munguar, gjithashtu tentojnë të na shkaktojnë dëme të mëdha edhe në imazhin e kompanisë sonë.

Pergjigjia e Autoriteteit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore

Sa i përket pretendimit te parë, për pune te kryera ne vlerë 3 milion euro, pajtohem me këtë pretendim tuajin dhe e konsideroj si **te bazuar**, komisioni i vlerësimit te tenderit i ka kontestuar pranimet e përkohshme te punëve, gjithashtu se dokumentet e pranimeve te ofruara nga ana juaj nuk kanë as vullë e as protokoll të Autoritetit të cilin e përfaqësojnë personat që kanë nenshkruar në atë dokument. Po ne këtë fazë ZPP pas shqyrtimit te dokumentacioneve, pajtohem se ju e plotësoni kriterin e punëve te kryera ne vlerë 3 milion euro ne tri vitet e fundit siç është kërkuar ne NJK dhe ne DT.

Sa i përket pretendimit te dyte ankimor rreth dy Deklaratave nen Betim te nenshkruara nga Valon Ademi dhe ku dallon nenshkrimi ne mes dy deklaratave, andaj këtë pretendim ankimor e konsiderojmë **të pa bazuar**, meqenëse ne nuk e kemi kontestuar te drejtën e pjesëmarrjes ne konsorcium te dy kompanive ku pronar rrespektivisht administrator është i njëjti person, derisa nuk ka konflikt interesi, por kontestues është nenshkrimi i dy deklaratave nen betim me emrin e njëjtë Valon Ademi dhe me nenshkrime te ndryshme.

Ne ofertën e juaj ju nuk e keni prezantuar Autorizimin e 2A Group për znj. Hamdije Idrizi-Krasniqi te cilën e dëshmoni tani ne Kërkesën tuaj për Rishqyrtim. Por edhe sikur ta kishit prezantuar këtë autorizim, ne Deklaratën nen Betim te kompanisë 2A Group nuk është dashtë te shënohet emri Valon Ademi e te nenshkruaj znj. Hamdije Idrizi-Krasniqi ne emër te tije, por tek emri është dashtë te shënohet Hamdije Idrizi-Krasniqi e te nenshkruaj e njëjta ne emër te vet si e autorizuar.

Ne lidhje me këtë çështje është publikuar edhe një opinion nga KRPP si ne vijim:

14. 24.10.2023 A mund të nënshkruhen Deklarata nën betim dhe dokumentet tjera të Dosjes së Tenderit në emër të përfaqësuesit të Operatorit Ekonomik ofertues, nga një person i pa autorizuar?

Konform nenit 87, paragrafi 2, nën paragrafi 2.7 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, sa i përket çështjes së autorizimit, KRPP sqaron se çështja për të autorizuar një person që të nënshkruaj Deklaratën nën Betim dhe ose dokumentet tjera të Dosjes së Tenderit në emër të përfaqësuesit të

Operatorit Ekonomik nuk rregullohet me dispozita të LPP dhe legjislacionit dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë.

Çështja e autorizimit rregullohet me ligje tjera në fuqi në Republikën e Kosovës.

Megjithatë, opinioni i KRPP-së është si në vijim: Për derisa në Formularët Standard të Dosjes së Tenderit përfshirë “Deklaratën nën Betim” dhe dokumentet tjera (Kërkesa për qasje në dokumente zyrtare, Kërkesa për Sqarim, Formulari i Tenderit etj) në të cilat kërkohen të dhënat mbi identifikimin e përfaqësuesit të Operatorit Ekonomik (Emri dhe Mbiemri, pozita, nënshkrimi, data dhe vula), pra kërkohet të plotësohen dhe të nënshkruhen nga përfaqësuesi i Operatorit Ekonomik, rrjedhimisht të njëjtat dokumente nuk mund të nënshkruhen nga një person tjetër jo kompetent apo që nuk ka autorizim për të nënshkruar dokumentet në fjalë.

Në pamundësi të nënshkrimit të dokumenteve në fjalë nga përfaqësuesi i operatorit Ekonomik, i njëjti mund të veprojë sipas rregullave mbi autorizimin të përcaktuara me ligjet përkatëse në fuqi në Republikën e Kosovës.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit